



**PROJEKT RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK “PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT
TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË
EVADUARA**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK
“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË PERIUdhËN E
GJASHTËMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2023**

**MBI AUDITIMIN ME TEMË: “NDIHMJA JURIDIKE FALAS PËR PERSONAT NË
NEVOJË”**

NË SUBJEKTET:

- ✓ **MINISTRIA E DREJTËSISË**
- ✓ **DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS**

MARS 2025

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:.....	3
1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh.....	3
3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh.....	3
4. Statusi i pranimet të rekomandimeve.....	4
II. HYRJA.....	4
II.1 Objekti auditimit:.....	4
II.2 Qëllimi auditimit.....	5
II.3 Metodologjia e auditimit:	5
II.4 Konkluzioni.....	5
II.5 Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.....	6
III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	6
A. REKOMANDIME PËR NDRYSHIME LIGJORE.....	6
B. REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE.....	10
IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	28
V. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT.....	30
VI. ANEKS.....	31

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 1482 prot., datë 12.12.2024 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në gjashtëmujorin e dytë të vitin 2023”, ushtroi auditim tematik në 2 (dy) subjektet pjesë e Auditimit të Performancës me temë: “*Ndihma juridike falas për personat në nevojë*”, përkatësisht: Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

Auditimi i kryer në vitin 2023, kishte në fokus periudhën e auditimit 01.01.2020-30.06.2023 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me **Vendimin nr. 214, datë 18.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së** dhe Raporti Përfundimtar i shoqëruar me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me shkresat me nr. 447/8 dhe 447/9, prot., datë 19.12.2023. Auditimi u krye nga data 12.12.2024, deri më datë 17.01.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet e audituara përkatësisht MD dhe DNJF u mbajtën Akt-Verifikimet përkatëse të cilat janë regjistruar përkatësisht:

-Në Ministrinë e Drejtësisë, Akt-Verifikimi nr. 1, datë 16.01.2025.

-Në Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Akt-Verifikimi nr. 2 datë 16.01.2025;

Projektraporti u është dërguar subjekteve të mësipërm me shkresat përkatëse nr. 1482/1 prot. dhe nr. 1482/2 prot., datë 17.02.2025.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Nga auditimi u konstatua se,

- Ministria e Drejtësisë nuk ka dërguar në KLSH planin e masave 20 ditor.

- Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas me shkresën me nr. 115/1 prot., datë 10.01.2024, i ka përcjellë KLSH dhe Ministrisë së Drejtësisë, planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së, protokolluar me tonën me nr. 447/10, datë 11.01.2024., kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

-Ministria e Drejtësisë nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve.

- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me shkresën nr. 1650 prot., datë 23.07.2024, protokolluar me tonën me nr.447/142 datë 24.07.2023, ka dërguar raportimin 6 mujor në KLSH, sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, me një vonesë rreth njëmuajore, e kushtëzuar nga organizimi i një tryeze ndërinstitutionale.

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. shkresat me nr. 447/8 dhe 447/9, prot., datë 19.12.2023, janë rekomanduar gjithsej 18 masa:

Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore, 3 rekomandime.

Masa organizative, 15 rekomandime.

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të përcjella në KLSH mbi planin e masave si dhe shpjegimet e paraqitura për secilin rekomandim në fazën e verifikimit të tyre, rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore	3	2	1
2	Organizative	15	15	0

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të evaduara në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 23.06.2020.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 1482 prot., datë 12.12.2024. mbi Rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm me temë “*Ndihma juridike falas për personat në nevojë*” me konkluzionet përkatëse janë miratuar me **Vendimin nr. 214, datë 18.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së** dhe janë përcjellë në subjektet e audituara me shkresat me nr. 447/8 dhe 447/9, prot., datë 19.12.2023.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH-së, me përbërje:

1. A. S., përgjegjës grupi
2. B. K., anëtar
3. M. L., anëtare
4. Sh. H., anëtar.

Auditimi ka filluar më, 12.12.2024

Auditimi ka përfunduar më, 17.01.2025

II.1. Objekti i auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar në Ministrinë

e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, me shkresat me nr. 447/8 dhe 447/9, prot., datë 19.12.2023.

II.2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat e sipërcituara, rezulton se nga 18 (tetëmbëdhjetë) masa të rekomanduara gjithsej, nga të cilat 17 janë pranuar nga subjektet e audituara.

Nga masat e pranuar:

janë zbatuar 13 rekomandime ose 76% e tyre;

janë zbatuar pjesërisht 1 rekomandime ose 6% e tyre;

gjenden në proces zbatimi 3 rekomandime ose 18% e tyre;

ka vetëm 1 rekomandim të pazbatuar, meqë i papranuar, ose 6% e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Pa pranuar	Statusi i zbatimit për të pranuarat			
				Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim ligjor	2	1	1	-	1	-
b	Organizative	15	-	12	1	2	-

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave Për ndryshim apo përmirësim ligjor	Në numër	Në %
1	Totali	3	100%
2	Pa pranuar	1	33%
3	Pranuar	2	66%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	1	50%
2	Zbatuar pjesërisht	-	-
3	Në proces zbatimi	1	50%
4	Pa zbatuar	-	-

Nr.	Statusi i masave Organizative	Në numër	Në %
1	Totali	15	100%
2	Pa pranuar	-	-
3	Pranuar	15	100%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	12	80%
2	Zbatuar pjesërisht	1	7%
3	Në proces zbatimi	2	13%

4	Pa zbatuar	-	0%
---	------------	---	----

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Sikurse u konstatua gjatë auditimit, rezultoi se angazhimi i subjekteve kishte siguruar një nivel prej 80% zbatimi të rekomandimeve, nga ato të pranuar. Për disa nga masat e lëna, zgjatja e procesit të zbatimit të rekomandimeve është shkaktuar nga mosangazhimi i disa aktorëve, të cilët nuk kanë qenë subjekte auditimi. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi, kërkon më tepër impënjim nga subjektet e audituara për përmbushjen e rekomandimeve të lëna për ofrimin sa më efektiv të ndihmës juridike falas, për personat në nevojë.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit prej subjekteve të audituara, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacionit të tyre, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

5.1 Për pyetjen e auditimit. A kanë nxitur dhe siguruar politikat e hartuara mirë funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas?

5.1.1 A kanë shfrytëzuar MD dhe DNJF kompetencat e tyre në mirë administrimin e sistemit të ndihmës juridike falas?

2. Gjetje nga auditimi: Disa nga indikatorët e përcaktuar në metodologjinë e miratuar nga Ministria e Drejtësisë me qëllim vlerësimin e shërbimit të ndihmës juridike, si për shembull vlerësimi i cilësisë së dokumenteve të hartuara apo analiza e thelluar e çështjes së përfaqësuar nga avokati, janë të pa zbatueshëm.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë rishikimin e metodologjisë dhe kriterëve të vlerësimit të cilësisë së dhënies së shërbimeve të ndihmës ligjore.

Menjëherë

Përgjigje Ministrisë së Drejtësisë

DNJF-ja me shkresën nr.1053 prot., datë 07.05.2024, ka paraqitur kërkesën për bashkëpunim për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe Metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF-ja”.

Nëpërmjet kësaj shkrese, DNJF-ja, kërkon bashkëpunimin për ngritjen e një grupi pune të përbashkët pune me qëllim vlerësimin e propozimeve për ndryshimin e urdhërit.

DNJF-ja ka paraqitur propozimin jashtë afatit të përcaktuar në Plan Veprimin e Përcjellë në KLSH-në kuadër të zbatimit të Masave.

Pavarësisht kërkesës së DNJF-së për grup pune të përbashkët të MD-së dhe DNJF-së për vlerësimin mbi ndryshimin e Urdhërit, nga ana e DNJF-së së bashku me kërkesën është përcjellë dhe materiali i përgatitur, konkretisht Projekt Urdhrin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin 531, datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe Metodologjisë për

vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF-ja”, së bashku me relacionin shpjegues.

Praktika origjinale ka kaluar në Drejtorinë e Kodifikimit. Sektori ka administruar kopjen per dijeni. DNJF me shkresën nr. 1650 prot., datë 23.07.2024, drejtuar KLSH-së dhe për dijeni MD-së, ka raportuar se ky rekomandim është përmbushur. Në këto rrethana e kemi konsideruar të ezauruar përcjelljen e informacionit pranë Institucionit tuaj.

Përgjigje e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Metodologjia për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF të shërbimeve juridike është një metodologji e miratuar me Urdhrin nr. 531 datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë.

DNJF zhvilloi një analizë referuar praktikës dhe raporteve të vlerësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit mbi ndryshimet e nevojshme që duhen bërë apo përmirësuar në kriteret e vlerësimit të cilësisë së dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike falas.

Duke qenë se metodologjia është miratuar me urdher të Ministrit të Drejtësisë, është përgatitur shkresa nr. 1053 prot datë 07.05.2024 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 531 datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve juridike”, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë. Së bashku me shkresën kemi përcjellë:

- Projekt- Urdhrin “Për disa shtesa në Urdhrin nr. 531 datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”;
- Aneksi nr. 2 “Skeda e klientit të ndihmës juridike dytësore”, duke reflektuar ndryshimet e propozuara;
- Aneksi nr. 5 “Raporti i vlerësimit të strukturës organizative për ndihmën juridike parësore”, duke reflektuar ndryshimet e propozuara;
- Projekt-relacioni: “Për disa shtesa në Urdhrin nr. 531 datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 2604/2 prot., datë 01.07.2024, ka kërkuar ridërgimin e ndryshimeve të propozuara. Në përgjigje të kësaj shkrese, DNJF i është drejtuar përsëri Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 1056/2 prot. datë 09.07.2024, duke ripërcjellë propozimet për ndryshimin e metodologjisë. Jemi në pritje të përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë për vijimin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar, meqë DNJF ka ndërmarrë të gjitha veprimet në kompetencë të saj, që synojnë përmbushjen e zbatimit të rekomandimit.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

5.2 Për pyetjen e auditimit A është organizuar sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve?

5.2.2 A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike dytësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?

4. Gjetje nga auditimi: Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përkatësisht neni 25 krijon një vakum ligjor sa i përket mbulimit të shpenzimeve të ekspertëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve për personat në pamjaftueshmëri financiare, të cilët përfitojnë nga ndihma juridike dytësore falas. Tarifa e psikologut apo çdo eksperti tjetër gjatë fazës së ekzekutimit nuk përfshihet në skemën e ndihmës juridike dytësore falas, duke sjellë kështu vështirësi për përmbaruesit gjyqësor shtetëror gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të marrë masa që në nenin 25 të Ligjit 111/2017 të parashikohet edhe përjashtimi nga shpenzimet e tjera përmbarimore për personat e trajtuar me ndihmë juridike dytësore falas.

Menjëherë

Përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë

Me shkresën e saj me nr. 1056/2 prot., datë 9.7.2024, në lidhje me këtë çështje DNJF është shprehur se nuk ka qenë dakord me rekomandimin e lënë nga KLSH. Gjithashtu, në këtë shkresë DNJF është shprehur se duke vlerësuar rolin e Ministrisë së Drejtësisë, në hartimin e politikave për ndihmën juridike do të marrim në konsideratë të gjitha propozimet që do të vijnë nga tryeza e përbashkët me institucionet përgjegjëse. Në vijim me shkresën me nr. 1406/1 prot., datë 31.7.2024 me anë të së cilës janë përcjellë rekomandimet e evidentuara në tryezën e rrumbullakët, nuk është përcjellë ndonjë rekomandim për ndryshimin e nenit 25. Në tërësi DNJF nuk ka përcjellë ndonjë vlerësim apo propozim/projektligj konkret për ndryshime në ligjin nr. 111/2017. Në vijim, do të ngrihet një grup pune i posaçëm që do të vlerësojë në mënyrë të plotë, të përshtatshme dhe të qëndrueshme rekomandimin dhe nevojat për të kryer ndryshime konkrete në nenin 25, dhe jo vetëm, por për të gjithë rekomandimet përkatëse të cilat kërkohen të adresohen.

Përgjigje e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Sa i përket këtij rekomandimi, DNJF e ka shprehur qëndrimin e saj në objeksionet drejtuar KLSH se është një rekomandim që nuk mund të përmbushet, bazuar në legjislacionin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Evidentojmë këtu nenin 19 dhe nenin 25 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ku përcaktohet se: Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të ligjit “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:

- a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
- b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural);
- c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Sjellim në vëmendje, Udhëzimin nr. 6 datë 20.08.2019, “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtim në rastin e dhënies së ndihmës juridike” ku përcaktohet se: Pala ka të drejtë që të kërkojë përjashtim nga shpenzimet gjyqësore përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor dhe shpenzimet gjyqësore që lidhen me aktet e ekspertimit Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e shpalljes së vendimit nga gjykata për përjashtimin nga pagesat e shpenzimeve gjyqësore, DNJF kryen pagesat e shpenzimeve gjyqësore (tarifat e psikologut dhe ekspertëve të tjerë), sipas rradhës kronologjike të vendimeve gjyqësore të njoftuara dhe të plotësuara me dokumentacionin provues (sipas pikës 6 të udhëzimit).

Për sa më sipër, vlerësojmë DNJF, e konsideron këtë rekomandim të pazbatueshëm.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton i papranuar.

6. Gjetje nga auditimi: Referuar legjislacionit në fuqi, në faza të ndryshme të procedimit penal procesi i caktimit të avokatit mbrojtës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare bëhet nga organe proceduese të ndryshme. Kështu, në fazën e hetimit paraprak, e drejta për caktimin e avokatit mbrojtës i njihet organit procedues që fillon hetimet, pra, prokurorit. Ndërsa, në fazën e dërgimit të çështjes për gjykim, është gjykata ajo që shqyrton kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe vendos për përfitimin ose jo të saj.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të përcaktimeve ligjore në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që: *“në rastet kur kërkesa për përfitimin e ndihmës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare paraqitet nga i pandehuri që në fazën fillestare të hetimit dhe ai ka përmbushur kushtet për përfitimin e saj, atij ti ofrohet mundësia që edhe gjatë procesit të gjykimit të përfaqësohet me po të njëjtin avokat, që i është caktuar nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake, kur është e mundur”.*

Në vijimësi

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Nga DNJF, vihet në dukje se: Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, konkretisht neni 21 parashikon që në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare, kur organi procedues që vlerëson se janë përmbushur kriteret e përcaktuara në ligj, cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe njofton menjëherë personin të cilit i ofrohet ndihma juridike dytësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës.

Pika nr. 36 e Vendimit nr. 231 datë 12.11.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, në procesin penal”, parashikon se: “I padituri civil në procesin penal si rregull mbrohet nga i njëjti avokat i caktuar për të ndjekur procesin penal. Në rast se avokati nuk dëshiron të ndjekë çështjen civile, avokati zëvendësohet sipas rregullave të rotacionit dhe kalendarit të çështjeve”. Ndërsa në fazën e dërgimit të çështjes për gjykim, në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, është gjykata ajo që shqyrton kërkesën

për ndihmë juridike dytësore dhe vendos për përfitimin ose jo të saj. Pas dhënies së vendimit nga ana e gjykatës, organi kompetent për caktimin e avokatit është dhoma vendore e avokatisë sipas juridiksionit.

Në kushtet kur DNJF nuk ka diskrecion në caktimin e avokatit në asnjë fazë të gjykimit, i jemi drejtuar me shkresë informuese Ministrisë së Drejtësisë nr. 1080 prot datë 08.05.2024, me lëndë: “Mbi gjetjen nr. 6 të Raportit përfundimtar për auditimin e performancës me temë “Ndhurma Juridike Falas për personat në nevojë”.

Gjithashtu, në cilësinë e organeve kompetente për caktimin e avokatit për të ofruar ndihmë juridike dytësore, me shkresën me nr.1080/1 prot datë 20.05.2024, i jemi drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë. Nëpërmjet kësaj shkrese kemi kërkuar bashkëpunim ndërinstitucional me qëllim sigurimin e mirëorganizimit dhe mirëfungsionimit të institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike falas.

Më datë 31.05.2024, na është përcjellë shkresa me nr. 1080/2 prot, e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e cila ka vlerësuar kalimin për kompetencë dhe trajtim të praktikës, Prokurorisë së Përgjithshme. Nuk administrohet përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi

B. MASA ORGANIZATIVE

5.1 Për pyetjen e auditimit. A kanë nxitur dhe siguruar politikat e hartuara mirë funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas?

5.1.1 A kanë shfrytëzuar MD dhe DNJF kompetencat e tyre në mirë administrimin e sistemit të ndihmës juridike falas?

1. Gjetje nga auditimi: Për përcaktimin e pamjaftueshmërisë financiare, ligji nr. 111/2017 merr në konsideratë vetëm të ardhurat e një personi por jo shpenzimet e detyrueshme dhe të nevojshme për jetesë.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhurmës Juridike të kryejnë një analizë të mirëfilltë, për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike falas.

Brenda qershor 2024

Përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të monitorimit të DNJF ka vlerësuar rekomandimin e bërë nga KLSH dhe shkresat e DNJF dhe nëpërmjet një Memoje informuese vlerësuese me rekomandime përkatëse, ka sugjeruar ngritjen e një grupi pune ndërinstitucional.

Në vijim DPK ka sugjeruar vijimin e korrespondencave me MSHMS dhe nga ky komunikim, MSHMS me shkresën e saj Nr.2938/1, datë 09.07.2024 në përgjigje të shkresës së MD Nr.61/4, datë 26.06.2024, ka bërë me dije se MSHMS ka në fushën e përgjegjësisë së saj hartimin e politikave, të programeve dhe të legjislacionit të asistencës sociale.

Struktura përgjegjëse e monitorimit të DNJF në MD, ka mbajtur komunikim me DNJF, Ministrinë përgjegjëse dhe DPKHL, e se fundmi ka rezultuar se DNJF nuk mund të realizojë këto rekomandime pasi MD nuk është autoriteti përgjegjës për propozim të ndryshimeve në ligj.

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Në zbatim të këtij rekomandimi, DNJF i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 189 prot., datë 16.1.2024. Nëpërmjet kësaj shkrese DNJF ka kërkuar ngritjen e një grupi pune ndërinstytucional për kryerjen e një analize për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike falas.

Në shkresë është propozuar që pjesë e grupit ndërinstytucional të punës të jenë dhe përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Shërbimit Social Shtetëror dhe INSTAT në cilësinë e institucioneve qendrore qeveritare të cilat janë të përfshira në mënyrë direkte në çështjen e minimumit jetik për shkak të fushës së tyre të veprimtarisë.

Gjithashtu, DNJF i është drejtuar dhe organizatave ndërkombëtare mbështetëse me shkresën nr. 733 prot., datë 19.03.2024. Nëpërmjet kësaj shkrese kemi kërkuar mbështetje teknike për kryerjen e një analize për përcaktimin e kriterit të pamjaftueshmërisë financiare dhe përfitimit të ndihmës juridike falas. Nuk administrohet përgjigje nga organizatat.

Ndërkohë, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 61/4 prot., datë 26.06.2024, është mbajtur qëndrimi se përcaktimi i minimumit jetik nuk është në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë por të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke e konsideruar këtë rekomandim të pazbatueshëm.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi, brenda afatit kohor të përcaktuar nga KLSH.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson rekomandimin si të pranuar dhe zbatuar, pasi pavarësisht faktit që përcaktimi i minimumit jetik nuk është në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë e aq më pak të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, por të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sikurse nga dokumentacioni i vënë dispozicion, rezulton se subjektet kanë bërë çdo hap për të nxitur realizimin e objektivit të synuar nga rekomandimi i lënë.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Struktura monitoruese për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike në Drejtoria e Ndhmës Juridike përbëhet vetëm nga 2 specialistë, të cilëve iu duhet të monitorojnë dhe garantojnë zbatimin e standardeve të 160 avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore dhe 20 qendrave (QSHNJP) që janë të angazhuara në ofrimin e ndihmës juridike parësore.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shqyrtojë mundësinë e riorganizimit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike, me qëllim rritjen e efektivitetit të monitorimeve dhe garantimit të cilësisë së shërbimit.

Në vijimësi

Përgjigje e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

DNJF i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 695 prot., datë 13.03.2024, nëpërmjet të cilës propozon miratimin e 4 (katër) specialistëve shtesë në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike, me qëllim rritjen e efektivitetit të monitorimeve dhe garantimit të cilësisë së shërbimit.

Ky propozim është reflektuar edhe në hartimin e Projekt-Buxhetit Afatmesëm PBA (2025-2027) faza e parë, dërguar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 979 prot., datë 24.04.2024, si dhe në hartimin e Projekt-Buxhetit Afatmesëm PBA (2025-2027) faza e dytë, dërguar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 1878 prot., datë 28.08.2024.

Miratimi i numrit shtesë të specialistëve në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike kërkon rrjedhimisht edhe ndryshimin e strukturës së DNJF. Për këtë arsye me shkresën me nr. 1838 prot., datë 23.08.2024, DNJF ka propozuar pranë Ministrisë së Drejtësisë ndryshimin e strukturës së saj, duke parashikuar një rritje të numrit të specialistëve në Drejtorinë e Mbikëqyrjes (4 punonjës në total, 3 specialistë dhe 1 përgjegjës sektori).

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike nuk ka një sistem për të matur impaktin e aktiviteteve të zhvilluara me qëllim sensibilizimin e kategorive përfituese të ndihmës juridike falas. Pjesa më e madhe e aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike në këtë kuadër janë zhvilluar në tryeza të rrumbullakëta ose auditorë, ambiente në të cilat shumica e përfituesve të skemës juridike falas nuk kanë akses.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike, përpara hartimit të kalendarit vjetor të aktiviteteve, të zhvillojë analiza konkrete me qëllim forcimin dhe maksimizimin e impaktit në ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e ndihmës juridike .

Brenda qershor 2024

Përgjigje e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

DNJF ka hartuar analizën me qëllim forcimin dhe maksimizimin e impaktit në ndërgjegjësimin e publikut mbi sistemin e ndihmës juridike. Kjo analizë është përcjellë në KLSH dhe Ministrinë e Drejtësisë me shkresën me nr. 155/1 prot., datë 15.01.2024.

Në këtë analizë përcaktohen elementët ku duhet të bazohet Drejtoria në konceptimin e Kalendarit Vjetor të Aktiviteteve. Konkretisht: Zhvillimi i Aktiviteteve Ndërgjegjësuere me fokus kategoritë përfituese të ligjit të cilat referuar Analizave Statistikore janë më të pakta në numër përfituesish; Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere duke patur në fokus informimin e qytetarëve në bashkitë më të vogla (Çdo qendër e shërbimit të ndihmës juridike parësore e vendosur në qark do të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësuere në të gjitha bashkitë përbërëse të qarkut që kjo qendër mbulon. Psh: Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Elbasan do të angazhohet në sesione informuese sensibilizuese në qytetin e Belshit, Cërrikut, Gramshit, Librazhdit, Peqinit dhe Prenjasit).

Në vijim të analizës është hartuar dhe miratuar me Urdhër nr. 32, datë 17.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, Kalendari i Aktiviteteve për vitin 2024. Gjithashtu, janë konceptuar si pjesë integrale e Kalendarit Vjetor të Aktiviteteve, formatet TIP të raportimeve ku evidentohen të gjithë qytetarët të cilët kanë përfituar ndihmë juridike parësore si rrjedhojë e informimit përmes aktiviteteve ndërgjegjesuese/sensibilizuese të zhvilluara nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi, brenda afatit kohor të përcaktuar nga KLSH.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezultoi i pranuar dhe i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga intervista e zhvilluar me Drejtorin e Ndhmës Juridike, u konstatua se përveç koordinatorit për të drejtën e informimit, institucioni nuk ka një strukturë apo person përgjegjës që trajton ankesat e qytetarëve.

5.1 Rekomandimi: Drejtorin e Ndhmës Juridike Falas të përcaktojë një strukturë ose person përgjegjës për trajtimin e pretendimeve të ndryshme që vijnë nga qytetarët, lidhur me cilësinë e shërbimit të ofruar sistemi i ndihmës juridike falas.

Brenda dhjetor 2024

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Është hartuar dhe miratuar urdhri nr. 234, datë 30.04.2024, “Për caktimin e personave përgjegjës për trajtimin e ankesave të administruara në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas dhe Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore”, ndryshuar me urdhrin nr. 630, datë 20.12.2024.

Ky urdhër përcakton personat përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve si më poshtë: Për ankesat objekti i të cilave lidhet me veprimtarinë e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore caktohet një specialist përgjegjës nga Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore.

Për ankesat objekti i të cilave lidhet me veprimtarinë e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore caktohet një specialist përgjegjës nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve dhe Administrimit të Ndhmës Dytësore.

Për ankesat objekti i të cilave lidhet me veprimtarinë e financës dhe shërbimeve mbështetëse caktohet përgjegjës specialisti i burimeve njerëzore dhe shërbimeve.

Për ankesat të cilat administrohen pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë dhe rrethe caktohet si përgjegjës punonjësi i qendrës i cili është i ngarkuar për nënshkrimin dhe vulosjen e shkresave zyrtare.

Personi i ngarkuar për pranimin e ankesave, adresimin sipas objektit të veprimtarisë si dhe ndjekjen e procedurës deri në kthimin e përgjigjes caktohet nëpunësi i informacionit pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Secila drejtori shqyrton ankesat sipas fushës së saj të përgjegjësisë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi, brenda afatit kohor të përcaktuar nga KLSH.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit vlerëson rekomandimin si të pranuar dhe zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike nuk ka një program të planifikimit të trajnimeve vazhduese, në bazë të nevojave që lindin nga rastet praktike të trajtuara nga juristët. Krijimi i mundësive për zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme, si dhe kualifikimi në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira është i ulët.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me partnerë, të përgatisë një program të brendshëm trajnimesh vazhduese për të siguruar forcimin e kapaciteteve dhe aftësimin profesional të punonjësve me trajnim të posaçëm.

Në vijimësi

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Me qëllim përgatitjen e programit të brendshëm të trajnimeve vazhduese, me shkresën me nr. 420 prot., datë 09.02.2024, DNJF i është drejtuar punonjësve të qendrave, duke i kërkuar përcjelljen e tematikave të vlerësuara si të nevojshme nga ana e tyre për kryerjen e trajnimeve vazhduese.

Pas administrimit të nevojave për zhvillimin e trajnimeve vazhduese të përcjella nga punonjësit e qendrave, DNJF ka hartuar Programin e Planifikimit të Trajnimeve.

Ky program i është përcjellë Departamentit të Administratës Publike dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike me shkresën me nr. 514 Prot, datë 21.02.2024. Planifikimi i trajnimeve si dhe zhvillimi i tyre, është një detyrim ligjor i Departamentit të Administratës Publike dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike sipas përcaktimeve të nenit 9 shkronja “g” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Nga ana e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike është zhvilluar trajnimi vazhdues për periudhën 26 Mars deri në 3 Maj 2024. Pjese e këtij programi trajnimi ishte edhe moduli për hartimin e shkresave zyrtare dhe përpunimi tekniko-shkencor i dokumentacionit, si nevojë e evidentuar nga qendrat.

DNJF i është drejtuar për mbështetje edhe organizatave ndërkombëtare me shkresën me nr. 733 prot., datë 19.03.2024. Kjo kërkesë është marrë në konsideratë nga ana e organizatës Expertise France dhe Prezencës së OSBE në Shqipëri, të cilat kanë bërë të mundur zhvillimin e trajnimeve si më poshtë vijon:

- Trajnim i ofruesve të shërbimit të Ndhmës Ligjore Falas mbi të Drejtat Pronësore të Grave, datë 02.07.2024, në bashkëpunim me Expertise France.
- Trajnim Interaktiv “Komunikimi dhe Pritja e Qytetarëve nga Kategoritë e Veçanta” datë 31.10.2024, në bashkëpunim me OSBE.
- Manual “Si të përfitojmë ndihmë juridike” në gjuhën Brail, në bashkëpunim me OSBE.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i auditimit vlerëson rekomandimin të pranuar dhe të zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

5.2 Për pyetjen e auditimit. A është organizuar sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve?

5.2.1 A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike parësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?

1. Gjetje nga auditimi: Nga vizitat e zhvilluara në terren u konstatua numër i vogël të stafit që ofron shërbim në QSHNJP-të, të cilat funksionojnë me 1 ose në rastin më të mirë 2 juristë. Metodologjia e miratuar sugjeron se prania e vetëm 1 juristi për funksionet e pritjes së parë vlerësohet me “Këq”, ndërsa 2 të tillë vlerësohet me “Mirë”. Ky dokument sugjeron se vlerësimin “Shkëlqyeshëm” do ta merrte zyra me të paktën 5 juristë që kryejnë funksionet e pritjes së parë. Problematika bëhet më shqetësuese në zyrat që operojnë me vetëm një jurist, veçanërisht në drejtim të ndarjes/përcaktimit të detyrave, apo në rastet kur punonjësit i duhet të zhvillojë lejen e zakonshme.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të marrë masat e nevojshme për të evituar funksionimin e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore me vetëm një jurist, pasi të ketë analizuar edhe ngarkesën e secilës prej tyre.

Brenda qershor 2024

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

DNJF ka hartuar një Raport Studimor mbi Riorganizimin e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. Raporti Studimor, i cili i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 162 prot., datë 15.01.2024, ndalet në dy elementë kryesorë:

- Ngarkesa e punës së Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore (numri i rasteve të trajtuara dhe aktiviteteve të zhvilluara në raport me kohëzgjatjen ditore të punës) si për qendrat e hapura me buxhet shteti ashtu dhe për qendrat e mbështetura nga UNDP;
- Vijimësia e Qendrave të mbështetura nga UNDP, me përfundimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në Shkurt 2025.

Sa i përket ngarkesës në punë: Nga gjetjet e Raportit Studimor është evidentuar se ngarkesa e aktuale e punës është lehtësisht e përballueshme me një jurist për qendër, në kushtet kur nga analizat statistikore mujore, 1 qendër trajton mesatarisht 25 raste në muaj ose 1-2 raste në ditë. Përjashtimisht, 4 (katër) qendrat me performancë më të lartë si dhe përfaqësim më të madh të popullsisë në rang qarku, vlerësohet që të përbëhen nga 2 punonjës.

Sa i përket vijimësisë së Qendrave të mbështetura nga UNDP: Aktualisht DNJF administron me buxhet shteti 14 qendra. Me përfundimin e marrëveshjes me UNDP në Shkurt 2025, me qëllim garantimin e vijimësisë së shërbimeve, është e domosdoshme që 6 qendrat e mbështetura nga UNDP të kalojnë me buxhet shteti, duke shkuar në 20 qendra në total.

Referuar dy elementëve të sipërcituar, lind nevoja për pajisjen me punonjës shtesë për Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. Në këto kushte, DNJF i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 695 prot., datë 13.03.2024, nëpërmjet të cilës propozon miratimin e punonjësve shtesë për qendrat.

Ky propozim është reflektuar edhe në hartimin e Projekt-Buxhetit Afatmesëm PBA (2025-2027) faza e parë, dërguar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 979 prot., datë 24.04.2024, si dhe në hartimin e Projekt-Buxhetit Afatmesëm PBA (2025-2027) faza e dytë, dërguar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 1878 prot., datë 28.08.2024.

Miratimi i numrit shtesë të punonjësve të Qendrave kërkon rrjedhimisht edhe ndryshimin e strukturës së DNJF. Për këtë arsye me shkresën me nr. 1838 prot., datë 23.08.2024, DNJF ka propozuar pranë Ministrisë së Drejtësisë ndryshimin e strukturës së saj, duke parashikuar një rritje të numrit të punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (24 punonjës në total, 16 qendra me nga 1 punonjës dhe 4 qendra me nga 2 punonjës).

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi, brenda afatit kohor të përcaktuar nga KLSH.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezultoi i pranuar dhe i zbatuar, meqë DNJF e ka bërë vlerësimin dhe analizën e ngarkesës së punës së juristëve të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, mbi bazën e të cilave angazhimi i tyre konsiderohet brenda kufirit të normës. Ndaj analiza e kryer mbi ngarkesën e punës, ka përcaktuar numrin e nevojshëm të punonjësve në këto qendra.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Në disa zyra (p.sh. Lezhë) nuk respektohet privatësia e qytetarit duke qenë se shërbimi ofrohet në ambiente të pa izoluara nga mjedisi përreth, apo zyrat pritëse ndajnë ambientet me punonjës të institucioneve të tjera (Fier). Gjithashtu, zyra e Tiranës nuk është e pajisur me një rampë, për të mundësuar aksesin e qytetarëve me aftësi të kufizuara. Metodologjia e miratuar vlerëson me “Keq” rastet kur zyrat e brendshme nuk janë të izoluara nga mjedisi përreth. Ndërkohë, vlerësohet me “Shumë keq” zyra, e cila është plotësisht e pa-aksesueshme nga disa kategori personash me aftësi të kufizuara.

2.1 Gjetje nga auditimi: Në disa raste, edhe vetë kriteret e miratuara janë të vështira për tu zbatuar nga monitoruesit dhe lidhin performancën e qendrave me çështje që nuk janë në kompetencën e punonjësve të tyre. Po ashtu, kriteret e lidhura me nivelin e arsimit dhe eksperiencën në punë nuk reflektojnë një vlerësim të drejtë, për aq kohë sa punonjësi ka plotësuar kërkesat e vendosura gjatë procesit të rekrutimit.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të marrë masat që Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore të ofrojnë të gjitha facilitetet e nevojshme, në përputhje me standardet e miratuara.

Brenda qershor 2024

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Nga ana e KLSH është konstatuar se në disa zyra (p.sh. Lezhë) nuk respektohet privatësia e qytetarit duke qenë se shërbimi ofrohet në ambiente të pa izoluara nga mjedisi përreth, apo zyrat pritëse ndajnë ambientet me punonjës të institucioneve të tjera (Fier). Gjithashtu, zyra e Tiranës nuk është e pajisur me një rampë, për të mundësuar aksesin e qytetarëve me aftësi të kufizuara.

Bazuar në konstatimet dhe rekomandimet e KLSH, DNJF ka ndërmarrë masat si më poshtë vijon:

Sa i përket QSHNJP Lezhë:

Me shkresën me nr. 316 prot., datë 31.01.2024, i jemi drejtuar Bashkisë Lezhë me qëllim mundësimin e një ambienti të veçuar me qëllim respektimin e privatësisë së qytetarëve. Nga ana e Bashkisë Lezhë, është bërë i mundur riorganizimi i posteve të punës duke mundësuar një ambient të veçuar për funksionimin e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Lezhë.

Sa i përket QSHNJP Fier:

Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore ndan të njëjtën zyrë (poste të mëvetësishme pune) me zyrën vendore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Fier. Kjo në saj të Marrëveshjes tre palëshe të Bashkëpunimit midis DNJF, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Këshillit të Qarkut Fier. Duke u nisur nga natyra e veprimtarisë së shërbimit të ofruar; misioni relativisht i ngjashëm i të dy institucioneve (mbrojtja e kategorive vulnerabël) si dhe fakti që personat e diskriminuar janë kategori drejtëpërdrejtë përfituese e ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, DNJF mban qëndrimin se të qënurit në një zyrë me përfaqësuesin vendor të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, jo vetëm që nuk ka sjellë pengesa në drejtim të ofrimit të shërbimit, por përbën një mundësi më gjithëpërfshirëse për individët në nevojë në drejtim të garantimit të aksesit në drejtësi.

Sa i përket QSHNJP Tiranë:

Referuar rekomandimeve të KLSH, zyra e Tiranës nuk është e pajisur me një rampë, për të mundësuar aksesin e qytetarëve me aftësi të kufizuara. Bëjmë me dije se prej muajit Mars 2024, qendra e Tiranës është zhvendosur në katin 0 të Ministrisë së Drejtësisë duke bërë të mundur në këtë mënyrë aksesin nga individët me aftësi të kufizuara.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi, brenda afatit kohor të përcaktuar nga KLSH.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

DNJF ka ndërmarrë të gjitha veprimet në kompetencë të saj, për të sensibilizuar aktorët e tjerë të përfshirë në administrimin e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore. Kjo nxitje e DNJF për institucionet që kanë në pronësi mjediset rezulton e dokumentuar.

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Pjesa më e madhe e OJF-ve të autorizuara nga Ministria e Drejtësisë operon në Tiranë dhe numri i rretheve të mbuluara nga këto organizata mbetet shumë i kufizuar. Konkretisht, 10 nga 15 OJF-të e autorizuara ndodhen në Tiranë, ndërsa rrethet Shkodër, Durrës, Vlorë, Berat dhe Elbasan kanë përkatësisht nga një organizatë të tillë.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, të hartojë një plan veprimi me synim rritjen e numrit të Organizatave Jo-Fitimprurëse të autorizuara që ofrojnë ndihmë juridike parësore, me fokus të veçantë në rrethet të cilat nuk kanë asnjë organizatë të tillë.

Brenda mars 2024

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

DNJF me shkresën me nr. 314 prot., datë 30.01.2024, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (institucioni përgjegjës për administrimin e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë) me qëllim vendosjen në dispozicion të listës së organizatave jofitimprurëse që kanë si pjesë të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimit ligjor falas.

Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën me nr. 785/1 prot., datë 06.03.2024, na është vendosur në dispozicion një listë e organizatave jofitimprurëse që kanë të përcaktuar në statutin e tyre ofrimin e shërbimit ligjor pa pagesë.

Të gjitha organizatat jofitimprurëse të përfshira në listën e dërguar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë njoftuar në rrugë shkresore (respektivisht me shkresat me nr. 1715 prot., datë 31.07.2024; dhe 1715/1 prot., datë 31.07.2024) mbi procedurën e autorizimit nga Ministri i Drejtësisë, për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Sa më sipër, theksojmë që të gjitha organizatat jofitimprurëse të cilat operojnë në territorin e RSH dhe kanë për objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e ndihmës juridike, sipas të dhënave të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi procedurën e autorizimit nga Ministri i Drejtësisë, për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Thekojmë që përpos vullnetit të organizatave për të marrë pjesë ose jo në thirrje, VKM nr. 55/2019, ka përcaktuar kriteret specifike për të përfituar autorizimin nga Ministri i Drejtësisë ku kriteri kryesor lidhet me eksperiencën në ofrimin e shërbimeve ligjore falas.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi, brenda afatit kohor të përcaktuar nga KLSH.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

DNJF, përveç hapave të pasqyruara në komentet e saja, rezulton se ka mundur hapjen e 6 Qendrave të Ndihmës Juridike Parësore, me miratimin e hartës së re gjyqësore, të 2 Klinikave Ligjore dhe kontributin e 14 OJF-ve të autorizuar për periudhën 2024-2026, duke arritur një shtrirje më të gjërë të ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe duke përmbushur kështu pjesërisht detyrimet e parashikuara në rekomandim. Pavarësisht masave nxitëse dhe veprimeve të marra nga DNJF, ka akoma rrethe të pambuluara nga ky shërbim.

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Përcaktimet e VKM-së nr. 110, datë 06.03.2019 në lidhje me financimin e OJF-ve të autorizuar nga buxheti i shtetit mund të bëhen pengesë për një pjesë të mirë të OJF-ve me eksperiencë për të përfituar nga kjo skemë.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, të interpretojë VKM-në për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse në mënyrë të tillë që të mos penalizohen OJF-të e autorizuar, të cilat kanë eksperiencë në ofrimin e ndihmës juridike.

Në vijimësi

Përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë

MD ka organizuar më datë 19.7.2024, një tryezë të rumbullakët me përfaqësues të MD, DNJF, OJF-ve, klinikave të ligjit dhe gjykatave. Në lidhje me këtë çështje vlejné komentet e dhëna nga DNJF mbi interpretimin e VKM.

Gjithashtu, theksojmë se MD, nëpërmjet DPKHL, ka realizuar tryezën e rumbullakët edhe për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 6.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”” më datë 28.02.2024, me përfaqësues të OJF-ve. Projektvendimi i është dërguar për shqyrtim e miratim dhe pritët të miratohet nga KM.

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

VKM nr. 110/2019, e ka të parashikuar shprehimisht që organizatat jofitimprurëse nuk mund të kenë 2 burime financimi për të njëjtin aktivitet. Çka do të thotë që një organizatë jofitimprurëse e cila përfiton grante nëpërmjet një projekti për ofrimin e ndihmës juridike për qytetarët në nevojë nuk mund të përfitojë njëkohësisht fonde nga buxheti i shtetit për ofrimin e të njëjtit shërbim. Kjo do të sillte një mbivendosje dhe për rrjedhojë një keqpërdorim të fondeve publike. Për këtë arsye, është në vullnetin e organizatës për të vendosur nëse do ta ushtrojë veprimtarinë e saj nëpërmjet projekteve apo nëpërmjet mbështetjes financiare të buxhetit të shtetit.

Nga ana tjetër, këtyre organizatave nuk iu privohet e drejta për të përfituar financim nga buxheti i shtetit pas përfundimit të projekteve që këto të fundit kanë. Vendosim në dukje se një ndër parimet e ndihmës juridike përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” është cilësia, eficienta dhe efikasiteti në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike.

Duke u bazuar në rekomandimet e KLSH, DNJF propozoi pranë Ministrisë së Drejtësisë zhvillimin e një tryeze të rrumbullakët me përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse të autorizuar, me qëllim diskutimin mbi mundësitë për interpretimin e VKM-së nr. 110, datë 06.03.2019, në lidhje me financimin nga buxheti i shtetit. (Shkresa me nr. 1406 prot., datë 20.06.2024). Kjo tryezë u zhvillua në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë më datë 19 Korrik 2024.

Referuar procesverbalit të mbajtur në takimin e datës 19 Korrik 2024, ku ishte ishte parashikuar një sesion i veçantë me përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, nga ana e DNJF u bë një sqarim për të gjithë organizatat pjesëmarrëse duke evidentuar si më poshtë vijon:

- Nëse një organizatë ka një projekt që ka të përfshirë si aktivitet “ofrimin e ndihmës juridike falas, fizikisht, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, kjo e fundit nuk mund të aplikojë për financim pranë DNJF pasi në këtë rast jemi përpara 2 burimeve të financimit për të njëjtin aktivitet;
- Nga ana tjetër nëse një organizatë ka një projekt që ka të përfshirë si aktivitet ofrimin e ndihmës juridike falas online apo ndërgjegjësimin e qytetarëve nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve informuese, atëherë kjo organizatë mund të aplikojë për financim pranë DNJF për dhënien e ndihmës juridike parësore fizikisht pasi nuk janë 2 aktivitete të njëjta për të cilat do të jepet financim.

Gjithashtu, në zbatim të rekomandimeve të KLSH, me urdhrin nr. 627, datë 17.12.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur Grupi i Punës “Për vlerësimin e ndryshimeve në metodologjinë e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë”. Qëndrimi i mbajtur në tryezën e datës 19 Korrik 2024, do të pasqyrohet edhe në ndryshimet e metodologjisë së financimit të OJF-ve për vitin 2025.

Metodologjia e financimit të OJF-ve, një metodologji e hartuar nga institucioni, miratuar me urdher të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas ka për qëllim garantimin e transparencës nëpërmjet konsolidimit të një sistemi të përcaktuar pikëzimi duke marrë në konsideratë eksperiencën e OJF-ve aplikuese; performancën gjatë periudhës së autorizimit; vendndodhjes së organizatës sa i përket aksesit etj. Kjo metodologji është hartuar duke marrë për bazë përvojën e DNJF referuar projekteve që ky institucion ka me donatorët (UNDP) por edhe Rregulloren e Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës mbi financimin e organizatave jofitimprurëse.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Sipas raportimeve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, Klinikat e ligjit nuk kanë ofruar shërbim gjatë vitit 2022.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, të propozojë pranë Ministrisë së Drejtësisë një plan masash me synim rivitalizimin e Klinikave të Ligjit, në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike parësore.

Brenda mars 2024

Përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë

DNJF me shkresë me nr. 809 prot., datë 02.04.2024, drejtuar Ministrit të Drejtësisë me lëndë: “Përcillet Plani i Masave me synim rivitalizimin e Klinikave të ligjit ku të përfshihen disa opsione” ka parashtruar planin e masave si vijon:

- Nevoja për ndryshime në ligjin nr. 111/2017, ku të mundësohet garantimi i një fondit të veçantë nga Ministria e Arsimit për funksionimin e Klinikave Ligjore pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë;
- Përcaktimi i një dispozite ligjore e cila i detyron IAL-të të ndërmarrin masat për funksionimin e Klinikave Ligjore;
- Përcjelljen e nevojës për mbështetje të Klinikave Ligjore të Drejtorisë së Projekteve dhe Strategjive në Ministrinë e Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë me shkresën me nr. 61/4 prot., datë 26.06.2024, ka mbajtur qëndrimin se ne kushtet kur ligji nr. 80/2015, për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë parashikon në mënyrë të qartë dhe shteruese rastet e financimit të IALV-ve me fonde publike, financimi i Klinikave të Ligjit mund të bëhet vetëm nëpërmjet ndryshimit të ligjit për arsimin e lartë duke mos qenë në fushën e përgjegjësisë së MD dhe DNJF.

Ky qëndrim u mbajt edhe në takimin e dt. 19 Korrik “Tryezë e rrumbullakët për mirësimin e skemës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti” ku ishte parashikuar një sesion të veçantë me përfaqësues nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

DNJF me shkresën me nr. 809 prot., datë 02.04.2024 (konceptuar më datë 29.03.2024) ka propozuar pranë Ministrisë së Drejtësisë një plan masash me synim rivitalizimin e Klinikave të Ligjit, në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike parësore.

Ministria e Drejtësisë me shkresën me nr. 61/4 prot., datë 26.06.2024, ka mbajtur qëndrimin se në kushtet kur ligji nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” parashikon në mënyrë të qartë dhe shteruese rastet e financimit të IAL-ve me fonde publike, financimi i Klinikave të Ligjit mund të bëhet vetëm nëpërmjet ndryshimit të ligjit për arsimin e lartë duke mos qenë në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe DNJF, si dhe duke e konsideruar këtë rekomandim të pazbatueshëm.

Ky qëndrim u shpreh edhe në tryezën e datës 19 Korrik 2024, ku ishte parashikuar një sesion i veçantë me përfaqësues nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” klinikë ligjore është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë. Gjithashtu, në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” përcaktohet se: “Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore. Siç parashtrohet më sipër, DNJF mund të angazhohet vetëm në drejtim të trajnimit të studentëve. Çdo hap tjetër i ndërmarrë shkon përtej kompetencave funksionale të institucionit në kushtet kur klinikat funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

DNJF ka ndërmarrë veprimet e mundshme, brenda fushës së saj të përgjegjësisë, për zbatimin e këtij rekomandimi, duke komunikuar me institucionet e tjera. Duke qenë Klinikat Ligjore financohen nga institucionet e arsimit të lartë, të cilat gëzojnë autonomi akademike, organizative dhe financiare, sikurse sanksionon ligji 80/2015, rijetëzimi i këtyre njësive do ishte i mundur vetëm pasi të ndryshonte ligji kornizë i arsimit të lartë. Komunikimet e DNJF në çdo rrethanë, do ishin kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm. DNJF ka përmbushur këtë kusht të nevojshëm, duke mos hezitur të nxisë interesimin për rijetëzimin e Klinikave, të cilat varen nga IAL-et.

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezultoi i pranuar dhe i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

5.2 Për pyetjen e auditimit. A është organizuar sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve?

5.2.2 A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike dytësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve?

1. Gjetje nga auditimi: Formulari i aplikimit “Për përfitimin e ndihmës juridike dytësore” dhe asnjë akt nënligjor që rregullon ofrimin e ndihmës juridike falas nuk përcakton specifikisht se cilat janë dokumentet që një person i interesuar për ndihmë duhet të bashkëlidhë për të vërtetuar që është në pamundësi financiare.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të përcaktojnë në Formularin e aplikimit “Për përfitimin e ndihmës juridike dytësore” edhe dokumentet që një person i interesuar për ndihmë duhet të bashkëlidhë për të vërtetuar që është në pamundësi financiare.

Brenda qershor 2024

Përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë

DNJF me shkresë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1054 prot., datë 07.05.2024, protokolluar në MD me nr. 2603 prot., datë 08.05.2024 me lëndë kërkesë për bashkëpunim për disa Shtesa në

urdhrit nr. 225, datë 25.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti". (rekomandimi 12) Praktika origjinale ka kaluar në Kodifikim, ndërsa fotokopja është administruar për dijeni në Sektor.

-Në vijim është diskutuar mes eprorëve ndjekja e praktikës.

-Ne vijim, DPKHL i ka kthyer përgjigje DNJF-së me shkresën nr. 2604/2 prot., datë 01.07.2024, nëpërmjet së cilës i bën me dije se DNJF-ja duhet të rishikojë dhe ridërgojë në Kodifikim propozimet në përputhje me këtë proces.

-DNJF me shkresën nr. 1056/2 prot., date 09.07.2024, ka kthyer përgjigje shkresës së DPKHL e cila i ka kthyer përgjigje DNJF-së lidhur me shkresën nr. 2604/2 prot., datë 01.07.2024, nëpërmjet së cilës i bënte me dije se DNJF-ja duhet të rishikojë dhe ridërgojë në Kodifikim propozimet në përputhje me këtë proces. DNJF-ja me shkresën e sipërcituar, i ka përcjellë edhe njëherë komentet dhe qëndrimin e saj ligjor "Mbi propozimet për ndryshime në aktet nënligjore" drejtuar MD-së. Kjo praktikë i ka kaluar DPKHL. (Në këtë shkresë DNJF ka qartësuar nevojën për ndryshimet në: Urdhrit N nr. 225; VKM nr.55; Urdhrit nr.531; së fundmi është qartësuar dhe interpretuar se nuk është dakord me ndryshimet në nenin 25 të ligjit nr. 111/2017, duke vënë theksin se problematikat do të diskutohen në një tryezë të përbashkët, e cila është realizuar. (Memo date 02.09.2024) për problematikat e tryezës së rumbullakët u kaluan me memo në DPKHL me miratimin e Ministrit. Me shkresën 2604/2 prot., datë 1.7.2024, të MD i është kërkuar DNJF që ndryshimet në Urdhrit nr. 225/2019 t'i përcjellë duke mbajtur në konsideratë procesin e derregullimit. Me shkresën e DNJF nr. 1056/2 prot., datë 9.7.2024 DNJF shprehet se është dakord me propozimin e MD, megjithatë në këtë shkresë nuk është përcjellë projekt urdhri përkatës me ndryshimet konkrete. Megjithatë MD do të vijojë të ndjekë në vijim procesin për ndryshimet në urdhrit nr. 225/2019.

Përgjigje e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Nga DNJF vihet në dukje se, duke patur parasysh se Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore kanë një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve dhe janë kontakti i parë me qytetarët, DNJF me shkresën nr. 385 prot datë 09.02.2024, i ka kërkuar qendrave përcjelljen e listës së dokumenteve shtesë të evidentuara të nevojshme, që duhet të bashkëlidhë një qytetar për të vërtetuar që është në pamundësi financiare.

Pasi kemi administruar të gjithë kthim përgjigjet nga ana e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore kemi hartuar Relacionin për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrit nr.225 datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti".

Gjithashtu, kemi hartuar projekt-urdhrit për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrit nr.225 datë 25.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti".

I jemi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 1054 prot., datë 07.05.2024, me lëndë "Kërkesë për bashkëpunim për disa shtesa në urdhrit nr. 225 datë 25.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti", duke bashkëlidhur relacionin dhe projekt-urdhrit.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 2604/2 prot., datë 01.07.2024, ka kërkuar ridërgimin e shtesave dhe ndryshimeve të propozuara. Në përgjigje të kësaj shkresë, DNJF i është drejtuar përsëri Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 1056/2 prot. datë 09.07.2024, duke ripërcjellë propozimet për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrit nr. 225 datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë. Jemi në pritje të përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë për vijimin e zbatimit të rekomandimit.

Linku i formularëve në gjuhën angleze: <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/legjislacion/>

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi, brenda afatit kohor të përcaktuar nga KLSH.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Në vijim të komunikimeve dhe ndërveprimeve midis DNJF dhe MD, urdhri i shtesave dhe ndryshime në urdhrin nr. 225 datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, pritet të miratohet, meqë MD është e angazhuar të vijojë të ndjekë në vijim procesin për miratimin e ndryshimeve të këtij urdhri.

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton i pranuar dhe në proces zbatimi.

Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Në Udhëzimin e Përbashkët nr. 1, datë 15.02.2023 ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë “*Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore*” nuk përcaktohen kritere për avokatët që do të angazhohen në proceset penale. Kriteret e parashikuara në këtë udhëzim aplikohen vetëm për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të marrë masa për hartimin e kritereve që duhet të plotësojnë avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset penale.

Në vijimësi

Përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë

DNJF ka përcjellë në MD shkresë mbi hartimin e kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen e avokateve në proceset penale - shkresa është me nr. 1055 prot., date 07.05.2024 protokolluar në MD me nr. 2602 prt., datë 08.05.2024. Kjo shkresë i është drejtuar Dhomes Kombëtare e Avokatisë së Shqiperise, ndërsa MD është për dijeni.

DNJF-ja në vijim të rekomandimit të Strukturës së Monitorimit, me shkresën nr. 1080/1, datë 20.05.2024, protokolluar në MD me nr. 2869, datë 21.05.2024, i është drejtuar me akt shkresor DHKASH dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke i bërë me dije se, në kuadër të mbajtjes në konsideratë të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, si dhe në rrethanat që ligji i ka njohur këto dy institucioneve si organet që kanë diskrecion në përcaktimin e avokatëve për të ofruar ndihmë juridike dytësore, kërkohet bashkëpunim ndër-institucional me qëllim sigurimin e mirëorganizimit dhe mirëfunksionimit të institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike falas.

Përgjigje e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përcakton në mënyrë të qartë që ofruesit e ndihmës juridike dytësore në proceset penale caktohen direkt nga organi procedues. Në Udhëzimin nr.1 datë 15.02.2023 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore” nuk përcaktohen kritere për avokatët që do të angazhohen në proceset penale. Kriteret e parashikuara në këtë udhëzim aplikohen vetëm për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative.

DNJF me shkresën nr.1055 prot datë 07.05.2024, i është drejtuar Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë duke kërkuar marrjen e masave mbi hartimin e kriterëve që duhet të plotësojnë avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset penale. Lidhur me kërkesën e DNJF, nuk kemi administruar një përgjigje të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Meqë DNJF ka ndërmarrë të gjitha veprimet në kompetencë të saj, për të zbatuar rekomandimin, pavarësisht se angazhimi i DNJF rezulton kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për zbatimin e tij, për sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Kontrolli i performancës së avokatëve bëhet vetëm në përfundim të procesit gjyqësor dhe pasi është dhënë vendimi nga ana e gjykatës për çështjen objekt gjykimi, pavarësisht pretendimeve dhe ankesave që mund të paraqesin në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas përfituesit e ndihmës juridike dytësore për cilësinë e shërbimit të avokatit gjatë përfaqësimit ligjor.

3.1 Gjetje nga auditimi: Disa nga indikatorët kryesorë të vlerësimit, me qëllim vlerësimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore janë të pa zbatueshëm (përshtatshmëria e cilësisë së shërbimit; cilësia e dokumenteve të hartuara, vlerësimi i analizës së thelluar të çështjes së përfaqësuar; etj.).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të analizojë mundësitë për krijimin e një procesi efektiv të vlerësimit të performancës së avokatëve të angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësore, që synon nxitjen e performancës së tyre.

Në vijimësi

Përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë

Referuar të raportimit të përcjellë nga DNJF për KLSH, ku thekson se për shkresën me nr. 1056/2 datë 9.07.2024 nuk ka marrë përgjigje nga Ministria e Drejtësisë ju bëjmë me dije se pas verifikimeve të kryera nga Sektorit i Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në fushën Civile, rezultoi, se shkresa është vijimësi komunikimesh me Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit. Konkretisht:

- DNJF me shkresën Nr. 1053 prot., datë 07.05.2024 protokolluar në MD Nr. 2604 prot., datë 08.05.2024 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim për disa shtesa në urdhrin nr.531/2019”- Sektori administroi kopje të praktikës por Drejtoria e Kodifikimit do të vijojë me veprimet për shkak se ka praktikën origjinale.
- DNJF me shkresën Nr. 1056/2 prot., datë 09.07.2024, protokolluar në MD Nr. 2604/3 prot., datë 11.07.2024 me lëndë “Kthim përgjigje shkresës së Drejtorisë së Kodifikimit me nr. 2604/2 prot., datë 01.07.2024”- Shkresa është vazhdimësi komunikimesh shkresore me Drejtorinë e Kodifikimit në përgjigje të shkresës 2604/2 prot., datë 01.07.2024. Sektori administroi kopje të praktikës pasi Drejtoria e Kodifikimit ka praktikën origjinale.
- DNJF me shkresën Nr. 1053/1 prot., datë 09.09.2024, protokolluar në MD Nr. 2604/4 prot., datë 10.09.2024 me lëndë “Ridërgim kërkesë mbi propozimin për disa shtesa dhe ndryshime

- në Urdhrin nr.531 "Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikqyrjes nga DNJF" – Praktika është përcjellë në Sektorin e Monitorimeve të Institucioneve të Varësisë Civile për dijeni duke qenë se origjinali i shkresës i është përcjellë DPK në vijim të komunikimit me DNJF.
- Memo e Drejtorisë së Kodifikimit me numër 989 prot., datë 30.09.2024 ku kërkohet qëndrimi i Sektorit të Monitorimeve të Institucioneve të Varësisë Civile. Kodifikimi ka kryer vlerësim në vijim të shkresës së DNJF nr. 1053/1 prot., datë 9.9.2024, shkresë e kaluar drejtëpërdrejtë në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit. Vlerësimi i Drejtorisë së Kodifikimit vjen edhe si pasojë e trajtimit të propozimit të parë të DNJF, për të cilën kodifikimi ka mbajtur qëndrim dhe ia ka përcjellë DNJF-së me akt shkresor me nr. 2604/2 prot., datë 1.7.2024. Sipas Drejtorisë së Kodifikimit, propozimi i DNJF-së është i gabuar. Datë 2.10.2024, SMIVC përgatiti një shkresë me qëndrimin e saj në të njëjtën linjë si qëndrimi i kodifikimit dhe ia përcolli me akt shkresor DNJF.
 - Sipas ndryshimit të propozuar është shtuar rubrika “komente nga përfituesi për trajtimin nga avokati gjatë përfitimit të shërbimit juridik” ku përfituesi i ndihmës juridike të japë një përkrahje të shkurtër në lidhje me ofrimin e shërbimit nga avokati, trajtimin me përparësi të çështjes dhe në trajtimin me dinjitet nga avokati.
 - Sa i përket nismës për ndryshimin e urdhrit nr. 531/2019, MD vlerëson se ndryshimet e propozuara, nuk i përmbahen rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili ka rekomanduar që DNJF të monitorojë secilin avokat gjatë ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore, duke mbikëqyrur edhe veprimtarinë e avokatit gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore. Nga parashtrimet e mësipërme arrijmë në konkluzionin se, duke mbajtur në konsideratë formimin e përfituesit të ndihmës juridike dytësore, propozimi i DNJF-së, nuk do të ishte efektiv dhe eficient, pasi pjesa më e madhe e personave që përfitojnë nga ndihma juridike dytësore, nuk kanë informacionin dhe ekspertizën e duhur për të vlerësuar veprimet e avokatit, përpara dhe gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor (shkresa e MD nr. 2604/2 prot., datë 1.7.2024). Në kuadër të rishikimit të procesit, mbetemi në pritje të gjetjeve nga ana e DNJF dhe propozimit të mekanizmave konkrete prej saj, në mënyrë që procesi i vlerësimit të performancës së avokatëve të angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike dytësor të jetë efektiv.

Përgjigje e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Në zbatim të Urdhrit nr. 531 datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike” me qëllim vlerësimin e performancës së avokatëve, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kryen monitorimet fillestare dhe monitorimet e vazhdueshme. Pas përfundimit të monitorimeve në terren kryhet vlerësimi i performancës së avokatit. Vlerësimi i performancës kryhet në përfundim të çështjes gjyqësore për secilin avokat, bazuar në monitorimet e vazhdueshme.

Metodologjia për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF të shërbimeve juridike është një metodologji e miratuar me Urdhrin nr. 531 datë 25.11.2019, të Ministrit të Drejtësisë.

DNJF zhvilloi një analizë referuar praktikës dhe raporteve të vlerësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit mbi ndryshimet e nevojshme që duhen bërë apo përmirësuar në kriteret e vlerësimit të cilësisë së dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike falas.

Duke qenë se metodologjia është miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, është përgatitur shkresa nr. 1053 prot datë 07.05.2024 me lëndë “Kërkesë për bashkëpunim për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr. 531 datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për

vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve juridike”, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë. Së bashku me shkresën kemi përcjellë:

- Projekt- Urdhrin “Për disa shtesa në Urdhrin nr. 531 datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike;
- Aneksi nr. 2 “Skeda e klientit të ndihmës juridike dytësore”, duke reflektuar ndryshimet e propozuara;
- Aneksi nr. 5 “Raporti i vlerësimit të strukturës organizative për ndihmën juridike parësore”, duke reflektuar ndryshimet e propozuara;
- Projekt relacioni: “Për disa shtesa në Urdhrin nr. 531 datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 2604/2 prot. datë 01.07.2024, ka kërkuar ridërgimin e ndryshimeve të propozuara. Në përgjigje të kësaj shkrese, DNJF i është drejtuar përsëri Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 1056/2 prot. datë 09.07.2024, duke ripërcjellë propozimet për ndryshimin e metodologjisë. Jemi në pritje të përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë për vijimin e zbatimit të rekomandimit.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi. Ky rekomandim lidhet ngushtë me rekomandimin nr.2 (evidentuar më sipër).

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar, meqë DNJF ka ndërmarrë të gjitha veprimet në kompetencë të saj, me synim zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk harton një listë të posaçme të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre, sikurse diktohet nga neni 31 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të kërkoj nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë hartimin e listave të veçanta të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur dhe përfaqësimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigje e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Përpilimi i listave të avokatëve ofruar të shërbimit të ndihmës juridike dytësore është një ndër funksionet e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

Në kuadër të bashkëpunimit dhe përmbushjes së rekomandimit, i jemi drejtuar me shkresë Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe për dijëni Ministrinë e Drejtësisë me shkresën nr. 317 prot datë 31.01.2024 me lëndë “Mbi hartimin e listës së posaçme të avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur që do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike dytësore për vitin 2024”. Në këtë shkresë

kemi kërkuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë të hartojë listën e avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur.

Bashkëpunimi me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë në kuadër të hartimit të listës u përmbush me sukses dhe u përçoll lista e avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas e ka publikuar listën në faqen zyrtare web të saj.

Linku i faqes zyrtare web të listës së avokatëve ofruet të shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2024:

<https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/publikime-2/publikime-drejtoria-e-mbikeqyrjes-se-standarteve-dhe-administrimit-te-ndihmes-dytesore/lista-e-avokateve-qe-ofrojne-sherbimet-e-ndihmes-juridike-dytesore/>

Linku i faqes zyrtare web të listës së avokatëve të specializuar në drejtësinë për të mitur:

<https://ndihmajuridike.gov.al/ep-content/uploads/2024/12/Lista-e-avokateve-per-te-miturit..docx>

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton i pranuar dhe i zbatuar.

Statusi i rekomandimit: I zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka ushtruar të drejtën e ankimit për periudhën 2020-2022 në 122 raste, nga të cilat rezulton se, vetëm 2 kërkesa ankimore janë pranuar nga Gjykata e Apelit. DNJF e ka vënë në lëvizje gjykatën nëpërmjet ankimit edhe për raste që nuk parashikohen në nenin 22 pika 7 të Ligjit nr. 111/2017 (vetëm kur pretendon se vendimi i marrë nga gjykata ka qenë *dukshëm abuzim ose haptazi i pabazuar*).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të ushtrojë të drejtën e ankimit të vendimeve gjyqësore vetëm në rastet e cituara në mënyrë eksplicite në ligj. Në çdo rast tjetër, për pretendime që nuk lidhen me kërkesat e nenit 22 të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, DNJF mund ti drejtohet gjykatës që ka marrë vendim për pranimin e kërkesës dhe të kërkoj plotësim të vendimit, saktësim apo interpretim të tij.

Në vijimësi

Përgjigje e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

DNJF vë në dukje se në funksion të pikës 9, të nenit 22, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ku parashikohet se: “Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Në këtë rast zbatohen afatet dhe rregullat për ankimin e vendimeve përfundimtare, sipas dispozitave të legjislacionit procedural. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë”, ushtron të drejtën e ankimit vetëm për rastet kur kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar, pasi nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit për sa i takon kategorive të veçanta ose kriteret e përcaktuara në nenin 12 të ligjit mbi pamjaftueshmërinë e të ardhurave dhe të pasurisë.

Ndërsa për çdo rast tjetër, DNJF vijon procedurën duke ushtruar të drejtën për ndreqje gabimi, interpretim ose saktësim të vendimit të gjykatës për dhënien e ndihmës juridike falas, referuar dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Civile.

Në kuadër të procesit të punës kemi hartuar një shkresë informuese për Ministrinë e Drejtësisë me nr. 822 prot datë 02.04.2024 me lëndë: “Shkresë mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas”.

Për sa më sipër, vlerësojmë se nga ana e DNJF, brenda fushës së përgjegjësisë së saj, janë ndërmarrë të gjitha hapat në drejtim të përmbushjes së këtij rekomandimi.

Qëndrimi i audituesit të KLSH:

Lidhur me sa më sipër dhe shkresës së lartpërmendur vënë në dispozicion, rekomandimi rezultoi i pranuar dhe në proces.

Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi

Në vijim të Projektraportit të dërguar, nga ana e subjekteve të audituara nuk janë paraqitur observacione lidhur me Akt-Verifikimet nr. 1 dhe nr.2, datë 16.01.2025, të mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit ***rikërkojmë*** nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, për masat pjesërisht të zbatuara, dërguar me shkresën nr. 447/8 dhe 447/9, prot., datë 19.12.2023, për Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Ndihma juridike falas për personat në nevojë*”, si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Për pyetjen e auditimit: 2. A është organizuar sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve?

Nënpyetja 2.2. A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike dytësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve? (Trajtuar më hollësisht në faqet 8-9 të Raportit Përfundimtar)

1. Gjetje nga auditimi: Referuar legjislacionit në fuqi, në faza të ndryshme të procedimit penal procesi i caktimit të avokatit mbrojtës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare bëhet nga organe proceduese të ndryshme. Kështu, në fazën e hetimit paraprak, e drejta për caktimin e avokatit mbrojtës i njihet organit procedues që fillon hetimet, pra, prokurorit. Ndërsa, në fazën e dërgimit të çështjes për gjykim, është gjykata ajo që shqyrton kërkesën për ndihmë juridike dytësore dhe vendos për përfitimin ose jo të saj.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të përcaktimeve ligjore në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që: “*në rastet kur kërkesa për përfitimin e ndihmës për shkak të pamjaftueshmërisë financiare paraqitet nga i pandehuri që në fazën fillestare të hetimit dhe ai ka përmbushur kushtet për përfitimin e saj, atij ti ofrohet mundësia që edhe gjatë procesit të gjyqimit të përfaqësohet me po*

të njëjtin avokat, që i është caktuar nga prokurori në fazën e hetimeve paraprake, kur është e mundur”.

Brenda vitit 2025

B. MASA ORGANIZATIVE

Për pyetjen audituese: 2. A është organizuar sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve?

Nënpyetja 2.1. A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike parësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve? (Trajtuar më hollësisht në faqet 15-21 të Raportit Përfundimtar)

1. Gjetje nga auditimi: Pjesa më e madhe e OJF-ve të autorizuara nga Ministria e Drejtësisë operon në Tiranë dhe numri i rrethëve të mbuluara nga këto organizata mbetet shumë i kufizuar. Konkretisht, 10 nga 15 OJF-të e autorizuara ndodhen në Tiranë, ndërsa rrethet Shkodër, Durrës, Vlorë, Berat dhe Elbasan kanë përkatësisht nga një organizatë të tillë.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, të hartojë një plan veprimi me synim rritjen e numrit të Organizatave Jo-Fitimprurëse të autorizuara që ofrojnë ndihmë juridike parësore, me fokus të veçantë në rrethet të cilat nuk kanë asnjë organizatë të tillë.

Brenda vitit 2025

Për pyetjen audituese: 2 A është organizuar sistemi i ofrimit të ndihmës juridike falas në funksion të realizimit të të drejtave të qytetarëve?

Nënpyetja 2.2. A kanë ofruar strukturat e ndihmës juridike dytësore shërbim cilësor ndaj qytetarëve? (Trajtuar më hollësisht në faqet 21-28 të Raportit Përfundimtar)

1. Gjetje nga auditimi: Formulari i aplikimit “Për përfitimin e ndihmës juridike dytësore” dhe asnjë akt nënligjor që rregullon ofrimin e ndihmës juridike falas nuk përcakton specifikisht se cilat janë dokumentet që një person i interesuar për ndihmë duhet të bashkëlidhë për të vërtetuar që është në pamundësi financiare.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të përcaktojnë në Formularin e aplikimit “Për përfitimin e ndihmës juridike dytësore” edhe dokumentet që një person i interesuar për ndihmë duhet të bashkëlidhë për të vërtetuar që është në pamundësi financiare.

Brenda vitit 2025

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka ushtruar të drejtën e ankimit për periudhën 2020-2022 në 122 raste, nga të cilat rezulton se, vetëm 2 kërkesa ankimore janë pranuar nga Gjykata e Apelit. DNJF e ka vënë në lëvizje gjykatën nëpërmjet ankimit edhe për raste që nuk parashikohen në nenin 22 pika 7 të Ligjit nr. 111/2017 (vetëm kur pretendon se vendimi i marrë nga gjykata ka qenë dukshëm abuzim ose haptazi i pabazuar).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të ushtrojë të drejtën e ankimit të vendimeve gjyqësore vetëm në rastet e cituara në mënyrë eksplicite në ligj. Në çdo rast tjetër, për pretendime që nuk lidhen me kërkesat e nenit 22 të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga

shteti, DNJF mund ti drejtohet gjykatës që ka marrë vendim për pranimin e kërkesës dhe të kërkoj plotësim të vendimit, saktësim apo interpretim të tij.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

VI. ANEKS

PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E PERFORMANCËS TË EVDUARA NË VITIN 2023, PËR AUDITIMIN ME TEMË “NDIHMJA JURIDIKE FALAS PËR PERSONAT NË NEVOJË”, NË SUBJEKTET: MINISTRIA E DREJTËSISË DHE DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomandu ar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranu ar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuara											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa për përmirësim ligjor	3		2		1		66%		1		-		1				-		-	
2	Masa organizative	15	-	15	-	-	-	100%		12		1		2				-		-	
TOTALI		18	-	17	-	1	-	-		13		1		3				-	-	-	-

